



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Address: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 26 shkurt 2010
Ref. Nr. MP 06/10

**Vendimi në Kërkesën për masa të përkohshme
në**

Rastin KI 73/09,

Mimoza Kusari-Lila

vs.

Komisioni Qendror Zgjedhor

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese e përbërë prej

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtare
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar

Pas procesit të këshillimit lidhur me Kërkesën për Masa të Përkohshme
paraqitur nga Mimoza Kusari-Lila, Gjykata miraton Vendimin si më poshtë:

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i Kërkesës, Mimoza Kusari-Lila, përfaqësuese e partisë politike, Aleanca Kosova e Re(AKR), gjithashtu kandidate për Kryetare Komune në Gjakovë/Dakovice në zgjedhjet lokale që u mbajtën në Kosovë me 15 nëntor 2009,

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Komisioni Qendror Zgjedhor(KQZ), siç është themeluar nga Neni 139 i Kushtetutës së Kosovës.

Objekt Shqyrtimi

3. Me 10 dhjetor 2009, parashtruesi i Kërkesës, Mimoza Kusari-Lila, paraqiti një Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në të cilën kërkon:
 - a) Vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Vendimit të KQZ-së, për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve lokale, të cilat u mbajtën me 15 nëntor 2009, pa konsideruar rezultatet e të gjitha ankesave dhe parashtresave që janë paraqitur.
 - b) Lejimin e Masave të Përkohshme, me qëllim që rezultati i zgjedhjeve në Komunën e Gjakovës/Dakovica të anulohet në vendvotimet , në të cilën procesi i zgjedhjeve është shkelur dhe urdhërimi i zgjedhjeve të reja nën mbikëqyrjen e KQZ-së.

Faktet

4. Pas zgjedhjeve lokale në Kosovë, që u mbajtën me 15 nëntor 2009, AKR dorëzoi një numër ankesash në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në të cilat shprehej shqetësimi për parregullsi të vëna re gjatë zgjedhjeve. Megjithatë, KZAP-i refuzoi këto ankesa, pas shqyrtimit të tyre. AKR apeloj dy prej vendimeve të KZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës hodhi poshtë këto ankesa në Aktgjykimet e datës 4 dhjetor 2009.
5. AKR paraqiti dhe një apel tjetër në Gjykatën Supreme të Kosovës, baza e së cilës ishte se KQZ-a shpalli rezultatet e zgjedhjeve lokale përpara se të ishin kryer të gjitha procedurat; e cila, sipas pohimit të tyre, ka shkelur Nenin 106.1 të ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë këtë apel me 4 dhjetor 2009.

Bazat ligjore

6. Neni 116.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 27 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe Neni 52.1 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese.

Konkluzioni

7. Gjykata, pasi konsideroi Raportin e Gjyqtarit Raportues Ivan Čukalović, dhe pasi dëgjoi palët në një seancë dëgjimore me 19 shkurt 2010 lidhur me këtë rast, arriti në përfundimin se Kërkesa për masa të përkohshme të hidhet poshtë; pa paragjykim të Vendimit përfundimtar mbi Kërkesën lidhur me lejueshmërinë ose mbi meritat. Gjykata arrin në përfundim se Parashtruesi i Kërkesës nuk ka parashtruar evidencë të mjaftueshme për të justifikuar anulimin e zgjedhjeve dhe urdhërimin për zgjedhje të reja nën mbikëqyrjen e KQZ-së. Parashtruesi i kërkesës nuk ka përcaktuar as që vënia e masave të përkohshme është e nevojshme për të shmangur ndonjë rrezik të dëmeve të pariparueshme, as se vënia e masave të përkohshme është në interesin publik, siç parashihet në Nenin 27 të ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese.
8. Për këto arsye, Gjykata unanimisht vendos:
- i. Hidhet poshtë Kërkesa për Masa të Përkohshme
 - ii. Ky Vendim do t'ju njoftohet Palëve;
 - iii. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe hyn në fuqi menjëherë.

Përpiluar në Prishtinë më 26 shkurt 2010

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

